**VENDIM**
**Nr.93, datë 3.2.2008**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË NDËRTESËS SË ISH-POLICISË NDËRTIMORE, DEGA TIRANË TE POSTA SHQIPTARE SHA, DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.363, DATË 11.6.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI POSTËS SHQIPTARE SHA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të ndërtesës së ish-Policisë Ndërtimore, dega Tiranë te Posta Shqiptare sh.a., sipas formularit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndërtesa e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të shtohet në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.363, datë 11.6.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Postës Shqiptare sh.a.".

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtori i Përgjithshëm i Postës Shqiptare sh.a. dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

**(Per inventarizimin e pronave te veçanta)**

Bashkia / Komuna: Tiranë

Fusha e perdorimit te Prones: Godine e Policisë së Ndërtimit Tirone

Identifikoi: [illegible] (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Sokol Veke (Sekretar i P) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Stavri Ristani (Zv. Minister) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | 8350 | 2/167 | truall + ndërtesë | Zyrat e Nd. N. Bonese Rr. = Jorden Misjan | truall 251 m² | ndërtesë 245 m² | Godine e Policisë së Ndërtimit Tiranë | M.P.P.T.T. | Inspektorati Ndërtimor Urbanistik | God dy Prongj |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |